



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 7888 Prot.

Tiranë, më 28.3 2019

UDHËZIM

Nr. 4... datë 28... 03. 2019

PËR
ZBATIMIN PRAKTIK TË REGJIMIT TË PËRPUNIMIT AKTIV

I. Baza ligjore

Ky udhëzim mbështetet në ligjin Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 27 deri 34, 45, 46, 81, 84, 191 deri 202, 228 deri 231, VKM nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenet 19 – 32, 529 deri 565, 687 deri 690; neni 737;

Në mbështetje të pikës 1(b)(i), të Pjesës VIII/1, të VKM Nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e Administratës Doganore”, të ndryshuar.

Qëllim i këtij udhëzimi është përcaktimi i saktë i procedurave doganore që zbatohen për miratimin, mbikëqyrjen dhe mbylljen e regjimit doganor të Përpunimit Aktiv.

II. Të përgjithshme

1. Mallrat nën regjimin e Përpunimit Aktiv (RPA) janë të pezulluara nga detyrimi doganor dhe pagesat e tjera, sipas parashikimeve në dispozitat përkatëse në fuqi si dhe masat e politikës tregtare, për aq sa ato nuk ndalojnë hytjen ose daljen e mallrave në ose nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

2. Kushti kryesor është që mallrat e importuara nën regjim duhet të identifikohen në produktet e përpunuara (pa cënuar përdorimin e materialeve ndihmëse dhe aksesoreve).

3. Kur mallrat e prodhuara ose mallrat që ishin importuar për përpunim çlirohen për qarkullim të lirë, për to nuk aplikohet pagesa e interesit kompensues. Pagesa e detyrimit doganor bëhet në momentin që mallrat e përpunuara çlirohen për qarkullim të lirë.

Autoritetet doganore mund të kërkojnë pagesën e detyrimeve në dy mënyra:

- a) Produkti i përpunuar çlirohet për qarkullim të lirë duke paguar detyrimet doganore për lëndën parë të importuar fillimisht (neni 81, pika 3 e Kodit);
- b) Produkti i përpunuar çlirohet për qarkullim të lirë duke paguar detyrimet doganore bazuar në detyrimet e zbatueshme për këto produkte.

Autoritetet doganore në zyrën doganore mbikqyrëse bazuar në gjëndjen në të cilën ndodhen mallrat që çlirohen për qarkullim të lire (produkte të përpunuara apo mallrat të papërpunuara), aplikojnë mënyrën sipas së cilës do të mbahet shuma e detyrimit doganor.

4. Për mallrat që importohen nën RPA *kërkoet autorizim* nga autoritetet doganore për përdorimin e regjimit.

5. Mallrat nën RPA mund të *transferohen në ambiente të tjera* brenda dhe jashtë territorit shqiptar për përpunim të mëtejshëm, duke u mbetur nën regjim. Gjithashtu mallrat nën një regjim doganor mund të *transferohen në një regjim tjetër doganor* që i përket të njëjtit mbajtës regjimi ose që i përket një mbajtësi të ndryshëm nga ai.

6. Autoritetet doganore, për të lejuar vazhdimësinë e proceseve të përpunimit mund të miratojnë *autorizim me efekt prapaveprues* në rastet kur plotësohen kushtet e përcaktuara për këtë qëllim në pikën 2, të nenit 192, të Kodit Doganor dhe nenin 546, të VKM nr.651, datë 10.11.2017.

7. Mallrat e importuara nën RPA janë të destinuara për *operacione përpunimi*, të tilla si:

- a) punimi i mallrave, duke përfshirë montimin, montimin ndërmjet tyre ose montimin e tyre në mallra të tjerë;
- b) përpunimi i mallrave (përfshirë të gjitha përpunimet e parashikuara në nenin 537 të VKM 651, datë 10.11.2017);
- c) Reduktimin në mbeturina dhe skrap, shkatërrimin, rikuperimin e pjesëve ose komponentëve;
- ç) riparimi i mallrave, përfshirë ndreqjen dhe rregullimin e tyre;
- d) përdorimi i mallrave që nuk gjenden në produktet e përpunuara, por që lejojnë ose lehtësojnë prodhimin e këtyre produkteve edhe nëse ato përdoren plotësisht ose pjesërisht në proces;
- dh) forma të zakonshme të lejueshme të trajtimit në përputhje me nenin 199 dhe aneksin 71- 03, shtojca A, të VKM nr.651, datë 10.11.2017;
- e) reduktimi në mbeturina dhe skrap, shkatërrimin, rikuperimin e pjesëve ose komponentëve;
- ë) denatyrimi;
- f) përpunimi i mallrave të listuara në aneksin 71-02, të shtojcës A, të VKM nr.651, datë 10.11.2017, në një nga situatat e mëposhtme:
 - mungesë totale e prodhimit të mallrave të krahasueshme brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;
 - mungesë e një sasive të mjaftueshme e këtyre mallrave, në mënyrë që të kryhen operacionet e parashikuara të përpunimit;
 - mallrat shqiptare të krahasueshme nuk mund të vihen në kohë në dispozicion të aplikuesit për operacionin tregtar të propozuar për t'u kryer, pavarësisht nga fakti se aplikimi është bërë në kohën e duhur.

8. *Koeficienti i shfrytëzimit* është sasia ose përqindja e produkteve të përpunuara të përfutuara nga përpunimi i një sasive të caktuar mallrash.

9. Autoritetet doganore autorizojnë përdorimin e “mallrave ekuivalente” në përpunim për prodhimin e produkteve të përpunuara. Mallrat ekuivalente janë mallra shqiptare, të cilat përdoren në vend të mallrave jo shqiptare për prodhimin e produkteve kryesore dhe më pas bëhet importi i mallrave jo shqiptare për zëvendësimin e tyre. Në nenin 201, të Kodit Doganor dhe nenet 541 deri 543, të VKM nr.651, datë 10.11.2017, janë të përcaktuara kushtet për përdorimin e këtyre mallrave nën RPA.

Mallrat e listuara në aneksin 71-02, të shtojcës A, të VKM nr.651, datë 10.11.2017, nuk mund të përdoren si mallra ekuivalente. Përdorimi i mallrave ekuivalente kërkon autorizim nga autoritetet doganore.

10. *Eksporti paraprak* është kur operatori ekonomik disponon një marrëveshje që e lejon atë të prodhojë produkte me mallra të barazvlefshme (mallra ekuivalente) dhe i eksporton ato para importit të mallrave zëvendësuese.

11. *Afati i autorizimit* për të përdorur Regjimin e Përpunimit Aktiv është *deri në 5 vjet*. Afati i autorizimit jepet me shumë se 1 vit deri në 5 vjet, kur operatori dhe aktiviteti për mallrat nën regjim plotësojnë kriteret, si vijon:

- disponon kontrata me një afat që mbulon të gjithë afatin e kërkuar;
- procesi i përpunimit kërkon një periudhë të gjatë për prodhimin e produktit përfundimtar;
- operatori ekonomik ka për tre vitet e fundit një aktivitet korrekt në zbatimin e regjimit të përpunimit aktiv, duke zbatuar të gjitha kriteret.

Ky afat nuk përdoret kur mallrat hyjnë nën regjim me anë të procedurës së thjeshtuar si dhe për mallrat e listuara në aneksin 71-02 “Mallra dhe produkte sensitive” të shtojcës A, të VKM nr.651, datë 10.11.2017.

12. *Afati i rieksporimit apo vendosjes në një regjim tjetër doganor* është periudha që duhet për përpunimin e mallrave dhe ri-eksportimin apo vendosjen e tyre nën një regjim tjetër doganor të produkteve të përpunuara. Ky afat llogaritet nga data e hyrjes së mallrave në territorin shqiptar.

13. *“Afati për mbyllje”* periudha në të cilën mallrat e vendosura nën një regjim të Përpunimit Aktiv ose produktet e përpunuara duhet të vendosen nën një regjim doganor pasues, të shkatërrohen, të nxirren jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë ose duhet të caktohen për përdorim të veçantë përfundimtar (end-use). Afati i mbylljes përfshin periudhën e vlefshmërisë së autorizimit, përfshirë këtu edhe kohën e përpunimit të përcaktuar në piken 13 të autorizimit. Në përfundim të këtij afati depozitohet dokumenti i mbylljes së regjimit.

14. *“Zyrë doganore e vendosjes nën regjim”*, nënkupton zyrën doganore të përcaktuar në autorizimin e regjimit të Përpunimit Aktiv për hyrjen e mallrave në territorin Shqiptar.

15. *“Zyrë doganore e mbikëqyrjes”* nënkupton zyrën doganore të përcaktuar në autorizimin e regjimit të Përpunimit Aktiv për mbikëqyrjen e regjimit.

16. *“Zyrë doganore e mbylljes”*, nënkupton zyrën doganore të përcaktuar në autorizimin e regjimit të Përpunimit Aktiv për rieksporimin e mallrave.

17. *Garancia*: kur sigurohet mbikëqyrja dhe funksionimi i duhur i regjimeve të përdorimit të veçantë dhe të përpunimit, autoritetet doganore mund të mos kërkojnë depozitim të një garancie.

18. Regjimi i Përpunimit Aktiv përfshin:

a) Miratimin e autorizimit për përdorimin e regjimit:

- bazuar në kriteret e parashikuara, autoritete doganore miratojnë autorizimin për përdorimin e regjimit të përpunimit aktiv.

b) Vendosjen e mallrave nën regjim:

- mallra jo shqiptare;
- mallra shqiptare.

c) Proçesin e përpunimit:

- punimi dhe përpunimi;
- montimi, shkatërrimi, riparimi, reduktimi, denatyrimi;
- ndryshimi i vetive, pamjes, cilësisë.

ç) Prodhimin e produkteve:

- produkte të përpunuara kryesore;
- produkte të përpunuara dytësore;
- humbjet/ firot gjatë proçesit të përpunimit.

d) Daljen e mallrave nga regjimi:

- rieksporimi i produkteve të prodhuara;
- asgjësimi;
- braktisja në favor të shtetit;
- deklarimi i humbjeve/firove;
- vendosja nën një regjim tjetër doganor;
- çlirim për qarkullim të lirë i produkteve të prodhuara;
- transferimi i mallrave/produkteve në një regjim tjetër të përpunimit aktiv.

dh) Mbylljen e regjimit

- depozitimi i dokumentit të mbylljes dhe afati për depozitim.

III. Kushtet dhe aplikimi për përfitimin e autorizimit për Regjimin e Përpunimit Aktiv

1. Autorizimi për të përdorur Regjimin e Përpunimit Aktiv u jepet *personave që plotësojnë kushtet* e mëposhtme:

- janë të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;
- japin sigurinë e nevojshme për funksionimin e duhur të operacioneve. Një operator ekonomik i autorizuar e plotëson këtë kusht;
- në raste specifike, kur kërkohet nga autoritetet doganore, depozitojnë garanci për mallrat nën regjim, në përputhje me nenin 84, të Kodit Doganor;
- i përdorin mallrat ose marrin përsipër përdorimin e tyre apo që kryejnë operacionet e përpunimit mbi mallrat ose marrin përsipër kryerjen e tyre;

- d) plotësimi i faktorit ekonomik gjatë kryerjes së operacioneve përpunuese, që nënkupton rritjen e vlerës së mallrave të përpunuara në atë masë që justifikon kostot e prodhimit dhe fitimin e operatorit ekonomik;
- dh) identifikimi i mallrave të importuara për përpunim në produktin e përpunuar, për të cilin përdoren metodat e mëposhtme:
- tregimi ose përshkrimi i markave të veçanta ose numrave të fabrikimit;
 - marrje mostrash, ilustrime, ose përshkrime teknike;
 - kryerje analizash;
 - shqyrtimi i regjistrave të magazinimit ose dokumente të tjerë mbështetës lidhur me transaksionin në fjalë, të cilët tregojnë qartë që produktet e përpunuara janë prodhuar nga mallrat e importit.
- e) autoritetet doganore janë në gjendje të ushtrojnë mbikëqyrjen doganore pa pasur nevojë marrjen e masave administrative në disproporcion me nevojat ekonomike në fjalë;
- ë) kur interesat thelbësorë të prodhuesve vendas nuk ndikohen negativisht nga një autorizim për një regjim përpunimi (kushtet ekonomike), sipas përcaktimeve në nenet 535 deri 537 të VKM nr.651, datë 10.11.2017.
2. Aplikimi për përfitimin e autorizimit të RPA bëhet sipas aneksit 8, të shtojcës C, të VKM nr.651, datë 10.11.2017 dhe paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD). Forma e aplikimit mund të jetë në portalin e-albania ose duke paraqitur aplikimin pranë sekretarisë së DPD-së.
3. Aplikimi duhet të ketë *bashkangjitur dokumentacionin* e mëposhtëm:
- kontratën e porosisë së operatorit ekonomik me firmat e huaja për përpunimin e mallrave;
 - deklarimin e operatorit ekonomik në lidhje me plotësimin e kushtit ekonomik(*aneksi 9*).
 - Në rastet kur importohen mallra të cilat për natyrën e tyre apo procesin teknologjik që kryhet humbasin pjesërisht apo tërësisht, paraqitet karta teknologjike dhe metoda që ndiqet për përcaktimin e koeficientit të shfrytëzimit.
 - në rastet kur parashikohet të ketë një ose disa operatorë paraqitet marrëveshja apo marrëveshjet mes operatorëve dhe aplikuesit të autorizimit, deklaratë e operatorit mbi vendndodhjen e ambientit ku do kryhet përpunimi dhe disponibiliteti i tij për kontroll në çdo kohë nga organi doganor, dokumenti i identifikimit të operatorit.
 - një argumentim të saktë ekonomik të aplikuesit në rastet kur, kërkohet që zyrat doganore të hyrjes, mbikëqyrjes dhe mbylljes së regjimit të jenë të ndryshme.
4. Drejtoria e Proçedurave Doganore në DPD merret me shqyrtimin e aplikimit dhe përgatitjen e autorizimit në përputhje me aneksin nr. 9 të Shtojcës C, të VKM nr.651, datë 10.11.2017. DPD miraton autorizimin për RPA, përveç rasteve kur kjo kompetencë i është deleguar Degëve Doganore për proçedurë të thjeshtuar.
5. Afati për miratimin e një autorizimi është 30 ditë. Në rastet kur autoriteti kompetent për lëshimin e autorizimit për arsye të justifikuara nuk ka lëshuar autorizimin brenda këtij afati njofton operatorin ekonomik se ky afat do të shtyhet edhe 30 ditë të tjera. Njoftimi i operatorit bëhet brënda afatit 30 ditor që duhet për shqyrtim.
6. Pas miratimit, autorizimi aktivizohet në sistem nga Sektori i Proçedurave dhe Regjimeve Doganore në DPD.

IV. Refuzimi i aplikimit, rivlerësimi, anulimi, revokimi/ndryshimi i autorizimit për RPA

1. Lidhur me aplikimin për autorizim RPA, autoriteti doganor zbaton rregullat e përgjithshme për vendimet që merren bazuar në aplikime, të përcaktuara në nenet 27 – 34 të Kodit Doganor dhe nenet 14 – 32, të VKM nr.651, datë 10.11.2017.
2. *Aplikimi refuzohet* në rastet e mëposhtme:
 - Aplikimi është i pasaktë dhe/ose i paplotë;
 - përdorimi i autorizimit nuk ka efekte ekonomike;
 - mallrat (lënda e parë) nuk mund të identifikohen në produktet e përpunuara;
 - operatori ekonomik ka detyrime të pashlyera ndaj administratës doganore;
 - nëse testi ekonomik, (i cili realizohet në rastet kur ka ankesa nga prodhuesit vendas apo mallrat ose operatori ekonomik janë klasifikuar me risk) rezulton negativ.
3. *Autorizimi, në raste të veçanta, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 28 të Kodit Doganor dhe të nenit 23, të VKM nr.651, datë 10.11.2017, mund të rivlerësohet:*
 - a) kur ka ndryshime në legjislacionin përkatës, që ndikojnë në autorizim;
 - b) kur është e nevojshme, si rezultat i monitorimit të kryer;
 - c) kur është e nevojshme, për shkak të informacionit të dhënë nga, mbajtësi i autorizimit, i cili mund të ndikojë në vazhdimësinë apo përmbajtjen e autorizimit, ose informacionit të dhënë nga autoritetet e tjera.
4. Autorizimi *anulohet* në rastet kur plotësohen njëkohësisht kushtet:
 - a) autorizimi është miratuar bazuar në informacion të pasaktë ose të paplotë;
 - b) personi, të cilit i është miratuar autorizimi, ishte në dijeni ose objektivisht duhej të ishte në dijeni që informacioni i dhënë ishte i pasaktë ose i paplotë.
5. Autorizimi *revokohet/ndryshohet* në rastet kur:
 - a) një apo më shumë nga kushtet, në bazë të të cilave është lëshuar autorizimi, nuk ishin përmbushur ose nuk përmbushen më; ose
 - b) me aplikim nga personi, ndaj të cilit është dhënë autorizimi.
6. Bazuar në nenin 45, të Kodit Doganor, aplikuesi/mbajtësi i autorizimit, ka të drejtë të ankimojë vendimet e marra nga autoritetet doganore për refuzimin e aplikimit apo vendimin për anulimin ose revokimin e autorizimit për regjimin e përpunimit aktiv.
7. Mbajtësi i autorizimit ka përgjegjësi që kodet tarifore të mallrave që vendosen në aplikim të jenë të sakta.
8. Mbajtësi i autorizimit duhet të njoftojë menjëherë Degën Doganore Mbikqyrëse në rastet e ndryshimit të kushteve të përcaktuara në autorizim.

V. Rinovimi i autorizimit, ndryshimet ose shtesat në autorizim

1. Aplikimi për përfitimin e Autorizimit të Përpunimit Aktiv për operatorët ekonomik që e kanë përfituar përdorimin e këtij regjimi doganor një ose më shumë herë dhe për të njëjtin

lloj aktiviteti përpunues, paraqitet sipas aneksit 8, Shtojca C, të VKM nr.651, datë 10.11.2017, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

2. Rinovimi i autorizimit të Përpunimit Aktiv lind si nevojë e përfundimit të afatit të përdorimit të autorizimit të mëparshëm. *Dokumentacioni i nevojshëm* që i bashkëlidhet aplikimit në këto raste, duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme:
 - a) kopjen origjinale të *proçes-verbalit* të mbajtur ndërmjet doganierit pranë zyrës doganore mbikëqyrëse dhe operatorit ekonomik/përfaqësuesit të tij, sipas *aneksit 1*, bashkëlidhur këtij udhëzimi. Proçes-verbali përmban të dhëna mbi:
 - sasinë, vlerën e miratuar dhe të realizuar;
 - verifikimin e koeficientit të shfrytëzimit dhe normativave të harxhimit të lëndëve të para;
 - evidentimin e mbetjeve teknologjike, skarciteteve dhe destinacionin doganor të tyre;
 - në rastet kur autorizimi i përfutur nuk konsumohet, lëshohet një dokument nga operatori ekonomik dhe/ose doganieri i regjimeve për arsyet e mosfunksionimit të tij.
 - b) kontratën e porosisë së operatorit ekonomik me firmat e huaja për përpunimin e mallrave;
 - c) në rastet kur parashikohet të ketë një ose disa operatorë paraqitet marrëveshja apo marrëveshjet mes tyre dhe aplikuesit të autorizimit si dhe deklaratë nga operatori lidhur me adresën e vendit ku do të bëhet përpunimi i mallrave si dhe gadishmërinë për ushtrimin e kontrolleve nga autoritetet doganore.
 - d) një argumentim të saktë ekonomik të aplikuesit në rastet kur, kërkohet që zyrat doganore të hyrjes, mbikëqyrjes dhe mbylljes së regjimit të jenë të ndryshme.
3. Më qëllim shmangien e ndërprerjes së aktivitetit të operatorit ekonomik që kërkon rinovimin e autorizimit të Përpunimit Aktiv, kërkesa mund të paraqitet 30 ditë para datës së përfundimit të autorizimit ekzistues.
4. Në rastet kur, gjatë kohëzgjatjes së Autorizimit për Përpunim Aktiv, lind nevoja e ndryshimeve ose shtesave të mundshme si rrjedhojë e ndryshimeve kontraktuale pjesërisht ose tërësisht si dhe në rastet kur lind nevoja e ndryshimit të përmbajtjes së një ose disa pikave të autorizimit për shkak të ndryshimit të rrethanave që kushtëzojnë funksionimin e aktivitetit, pranë Degës Doganore mbikëqyrëse paraqitet një kërkesë më shkrim në të cilën përshkruhen të gjitha argumentimet e nevojshme që justifikojnë ndryshimet apo shtesat.
5. Kërkesës së sipërpërmendur, në varësi të rastit, i bashkëngjitet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm si: kopje e autorizimit ekzistues dhe shtesë kontrate apo kontrata e re nëse është e nevojshme. Dega doganore mbikëqyrëse/operatori në rastet kur miraton shtesa në autorizim për të cilat kërkohet pasqyrim në sistemin informatik doganor duhet të njoftojë nëpërmjet e-mail-it Sektorin e Proçedurave dhe Regjimeve Doganore në DPD për përditësim. Miratohen nga dega doganore mbikëqyrëse ndryshimet në pikën 1, 5, 7, 8, 9, 12, 13 të autorizimit të regjimit të RPA-së.
6. Për ndryshime të pikave të tjera të autorizimit të RPA-së (të ndryshme nga ato të paraqitura në pikën 5) operatori ekonomik duhet të paraqesë aplikim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

7. Në rastet kur mallrat importohen dhe nuk janë të parashikuara në autorizimin e regjimit të Përpunimit Aktiv, nëse nuk miratohen ndryshimet në autorizim, për to do të paguhen detyrimet doganore.
8. Aplikimi për të përfituar një regjim të Përpunimit Aktiv, për rinovimin e tij apo për një ndryshim në autorizimin e marrë mund të bëhet on-line me funksionimin e sistemit të qëndërzuar të dokumentave me nënshkrim elektronik.

VI. Proçedura e thjeshtësuar.

1. Proçedurat e thjeshtuara të autorizimit mund të përdoren në këto raste:
 - a) operacionet që kanë të bëjnë më mallrat e një natyre jo-tregtare;
 - b) riparime të produkteve të përpunuara, përfshi edhe kontrollet e imta dhe rregullimet;
 - c) riparimin e mallrave, përfshirë ndreqjen dhe rregullimin e tyre;
 - ç) në rastet e importeve të rastësishme.
 - d) operacione për përpunim të mëtejshëm jashtë territorit shqiptar dhe rikthehen përsëri për përpunim përfundimtar.
2. Aplikimi për përdorimin e proçedurave të thjeshtuara që i përkasin shkronjës “a” deri “ç” të pikës 1, bëhet sipas *aneksit 2*, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe paraqitet pranë Degës Doganore mbikqyrëse të autorizimit.
3. Pranimi i aplikimit sipas *aneksit 2* nga Dega Doganore përbën miratimin e autorizimit.
4. Nuk përdoret proçedura e thjeshtuar në rastet e mëposhtme:
 - a) për mallrat e listuara në aneksin 71-02 të shtojcës A, të VKM nr.651, datë 10.11.2017;
 - b) përdorimin e deklaratës së thjeshtuar;
 - c) përdorimin e “mallrave ekuivalente”;
 - ç) kur kërkohet shqyrtimi i kushteve ekonomike;
 - d) kur përdorimi regjimit përfshin më shumë se një zyrë doganore.
5. Për proçedurën në shkronjën “d” të pikës 1, dega doganore mbikqyrëse, bazuar në aplikimin sipas *aneksit 8*, Shtojca C, të VKM nr.651, datë 10.11.2017, miraton autorizimin sipas *aneksit 9*, Shtojca C, të VKM nr.651, datë 10.11.2017, për mallrat nën regjimin e përpunimit aktiv apo produktet e përpunuara që rieksporthen përkohësisht, me qëllim përpunimin e mëtejshëm jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara për **regjimin e përpunimit pasiv**. Dokumentacioni që duhet të paraqitet bashkëlidhur aplikimit është:
 - a) kontrata me operatorit që do të përpunojë mallrat,
 - b) një deklaratë nga operatori ekonomik mbi proçeset e përpunimit që do të kryhen ose kartat teknologjike.

Mallrat nën regjim, do të eksporthen përkohësisht duke i vendosur në proçedurën e zgjeruar 2151 (kutia 37 e DAV) dhe do të rikthehen nën regjim me proçedurë të zgjeruar 6221 (kutia 37 e DAV). Deklaratat do të lidhen me numrin e autorizimit të Përpunimit Pasiv të miratuar nga dega doganore mbikqyrëse. Deklaratat do të mbahen në praktikë për të rregulluar situatën e regjimit në sasi dhe në vlerë.

6. Pas miratimit të autorizimeve për procedurat e paraqitura në pikën 1, dega doganore nëpërmjet e-mail-it njofton Sektorin e Procedurave dhe Regjimeve Doganore në DPD, për aktivizimin e autorizimit në sistemin informatik doganor.

VII. Vendosja e mallrave nën Regjimin e Përpunimit Aktiv.

1. Hyrja e mallrave në Regjimin e Përpunimit Aktiv nënkupton procedurën e importimit të përkohshëm të mallrave për përpunim, të cilat janë të parashikuara në autorizim.

2. Zyra doganore e vendosjes nën regjim është zyra doganore e përcaktuar në autorizimin për regjimin e RPA-së, siç referohet në pikën 1, të nenit 192, të Kodit, e cila është e autorizuar për vendosjen e mallrave nën regjim.

3. Tipi i deklaramentit për mallrat që hyjnë nën regjim është IM 5 dhe Degët Doganore ku hyjnë mallrat janë të përcaktuara në autorizim.

4. Kodet e kutisë 37 të DAV janë me 4 shifra.

a) *Dy shifrat e para* tregojnë procedurën e kërkuar dhe bazohen tek kodet e nënndarjes së dytë të kutisë 1, të deklaratës. Dy shifrat e para të kodeve që përdoren në kutinë 37 janë:

- 51 mallrat e vendosura në Regjimin e Përpunimit Aktiv.

b) *Dy shifrat e dyta* janë vijim i dy shifrave të para që përmenden më sipër dhe tregojnë regjimin e mëparshëm doganor. Prandaj, nënndarja e majtë e kutisë 37 do të ketë 4 shifra me kombinime të ndryshme, disa prej të cilave po i paraqesim më poshtë:

- 5100 – Futja e mallrave në regjimin e përpunimit aktiv pa pasur një regjim të mëparshëm doganor;

- 5151 – Transferimi i mallrave nën regjimin e përpunimit aktiv nga një autorizim tek tjetri;

- 5171 – Futja e mallrave në regjimin e përpunimit aktiv si vazhdim i regjimit të magazinimit doganor;

- 5178 – Futja e mallrave në regjimin e përpunimit aktiv duke ardhur nga një zonë e lirë ose magazinë e lirë;

5. Në procesin e prodhimit mund të përdoren dhe mallra shqiptare të cilat janë të ndryshme nga ato ekuivalente, të cilat duhet të deklarohen në akt-rakordimet përkatëse.

VIII. Përpunimi, prodhimi i produkteve.

1. Koeficienti i shfrytëzimit është sasia ose përqindja e produkteve të përpunuara të përfutuara nga përpunimi i një sasive të caktuar mallrash importi. Për përcaktimin e koeficientit të shfrytëzimit, duhen marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

a) sasia e produkteve kryesore të përpunuara, d.m.th produktet për të cilat është aplikuar për përfitim të regjimit të përpunimit aktiv;

b) sasia e produkteve dytësore të përpunuara;

c) mallrat e humbura apo të konsumuara gjatë përpunimit (humbjet në prodhim)

ç) sasia e aksesorëve dhe materialeve ndihmëse të prodhimit të përdorur për përfitim të mallrave të përpunimit aktiv.

2. Nëse përdoren shumë mallra të ndryshme importi për përfitim të një produkti të vetëm, atëherë koeficienti i shfrytëzimit shprehet si numri i secilit artikull importi që gjëndet në një produkt që rieksporohet. Nëse merret një artikull importi dhe ndahet në disa produkte të ndryshme, koeficienti i shfrytëzimit shprehet si sasia e artikullit të importit që prodhon një masë të caktuar në secilin produkt të përpunuar.

3. Koeficientët e shfrytëzimit, në rastet kur aplikohet për herë të parë, deklarohet si i llogaritur nga aplikuesi. Zyra doganore mbikëqyrëse pasi verifikon gjatë procesit të prodhimit koeficientin e miratuar dhe e gjen të ndryshëm me atë të kërkuar dhe të miratuar, dega doganore reflekton ndryshimin në autorizimin përkatës. Në rastet kur kërkohet rinovim i autorizimit për të njëjtën kategori mallrash dhe përpunimi, koeficienti i deklaruar bazohet në verifikimet e zyrës mbikëqyrëse gjatë periudhës së Autorizimit paraardhës.

4. Ky koeficient shfrytëzimi do të verifikohet nga doganieret përgjegjës për regjimet pranë zyrës mbikëqyrëse.

5. Verifikimi i koeficientit të shfrytëzimit përfshin:

- a) paraqitjen dhe ekzaminimin e mostrave sipas kartave teknologjike;
- b) shqyrtimin e kushteve të kontratës me furnitorët dhe klientët e operatorit ekonomik;
- c) vëzhgimin praktik të proceseve të përpunimit;
- ç) peshimin ose matjen e produkteve kryesore të prodhuara dhe produktet dytësore të përpunimit të përfutuara nga proceset e përpunimit;
- d) zbulimin e humbjeve gjatë prodhimit;
- dh) përcaktimin e materialeve ndihmese në procesin e prodhimit;
- e) evidentimin e sasive të mallrave të importit, aksesoreve të prodhimit, produkteve kryesore të prodhuara dhe produktet dytësore të përpunimit në librat e përpunimit aktiv të tregtarit si dhe në dokumente të tjera që lidhen me regjimin;
- ë) në veçanti, proceset komplekse të përpunimit mund të kërkojnë që përcaktimi i koeficientit të shfrytëzimit të bëhet me kontroll pas përpunimit;

6. Në përpunim mund të përdoren edhe mallra të cilat nuk gjenden në produktet kryesore të përpunuara, por që lejojnë ose lehtësojnë prodhimin e këtyre produkteve, edhe sikur ato të jenë përdorur tërësisht ose pjesërisht gjatë procesit të punës. Të tilla do të konsiderohen të gjitha ato mallra që shërbejnë si katalizatore ndihmës në procesin e prodhimit, apo ingredientë të rëndësishëm në procesin e prodhimit nëpërmjet të cilëve mallrave ju ndryshohet forma natyra apo cilësia. Në këtë grupim *nuk mund* të futet lënda djegëse, energjia elektrike, paisje dhe mjete apo materiale të tjera që i bashkëngjiten teknologjisë të cilat përdoret për kryerjen e operacioneve të përpunimit në këtë regjim (neni 687 i VKM nr.651, datë 10.11.2017).

7. Në këtë regjim hyjnë gjithashtu edhe ato mallra të cilët kthehen në gjendje të pandryshuar por që kontribuojnë në pamjen, rritjen e cilësisë dhe plotësimin e kërkesave të marketingut të produkteve kryesore të përpunuara.

8. Mallrat në regjimin e përpunimit aktiv mund përpunohen nga operatorë të tjerë brënda territorit shqiptar ose mund të eksportohen përkohësisht jashtë territorit shqiptar për përpunim të mëtejshëm dhe të rikthehen përsëri për përpunim përfundimtar.

9. Produktet që dalin nga përpunimi janë;

- a) “*Produkte kryesore të përpunuara*”, nënkuptojnë produkte të përpunuara për të cilat është dhënë autorizim për përpunim aktiv.
- b) “*Produkte dytësore të përpunuara*”, nënkuptojnë produkte të përpunuara, të cilat përbëjnë një nënprodukt i cili duhet të rezultojë domosdoshmërisht nga operacioni i përpunimit, ndryshe nga produktet kryesore të përpunuara.
- c) “*Humbjet/Firot*”, gjatë proceseve të prodhimit është pjesa e mallrave të importuara të cilat shkatërrohen dhe humbasin gjatë përpunimit, veçanërisht për shkak të avullimit, tharjes, çlirimit në trajtë gazi ose nga shpëlarja.

IX. Mbyllja e Regjimit të Përpunimit Aktiv

1. Pika 13 e formularit të autorizimit paraqet afatin e rieksporimit apo vendosjes nën një regjim tjetër doganor, i cili përfshin hyrjen, përpunimin, përgatitjen për riekспорт dhe daljen e produkteve të përpunuara.

2. Në bazë të nenit 230, të Kodit Doganor kjo periudhë mund të zgjatet pas një kërkesë të motivuar të mbajtësit të autorizimit.

3. Të gjitha mallrat që janë vendosur nën regjimin e përpunimit aktiv sipas kushteve dhe procedurave të sipër përmendura duhet që detyrimisht brenda afateve të autorizuara të dalin nga ky regjim. Mbajtësi i autorizimit është njëkohësisht edhe përgjegjës për mbylljen e RPA.

4. Mbyllja e regjimit të përpunimit aktiv nënkupton njërën nga procedurat e mëposhtme:

- riekспорт;
- shkatërrim/asgjësim nën kontrollin doganor;
- braktisje në favor të buxhetit të shtetit;
- transferim në autorizimin pasardhës ose transferimi nga një mbajtës i autorizimit të përpunimit aktiv tek një tjetër;
- vendosje nën regjimin e magazinimit doganor;
- hyrje në një zonë të lirë;
- çlirim për qarkullim të lirë brenda vendit.

4.1 Në rastin e rieksporimit në DAV do të plotësohet Kutia 1 EX 3. Rieksporiti bëhet vetëm në Degët Doganore që janë të miratuara në autorizim. Kombinimi i kodeve të kutisë 37 është:

- Kodi 3151- ri-eksporti i produkteve të përpunuara të dala nga mallrat e vendosura nën regjim;

4.2 Në rastin e shkatërrimit/asgjësimit, Kutia 1 IM 9, kutia 37 kombinohen kodet:

- Kodi 9351 asgjësimi i produkteve të dala nga proceset e përpunimit të mallrave nën regjim;
- Kodi 9951 humbje (firo) të dala gjatë procesit të përpunimit të mallrave të vendosura nën regjim;

Kur produktet dytësore të përpunimit *nuk kanë vlerë përdorimi* ju jepet destinacioni doganor i asgjësimit sipas procedurave të paraqitura më sipër.

Deklarimi doganor i operatorit ekonomik do të shoqërohet me një fletë peshoreje (nëse shoqëria ka një të tillë) ose me një deklaratë të operatorit ekonomik për peshën e mallrave. Nëse analiza e riskut përcakton kontroll fizik ky kontroll mund të bëhet edhe pranë ambjenteve të operatorit ekonomik. Dega doganore mbikqyrëse ngarkon të paktën dy doganierë për kryerjen e procedurave të cilët pas asgjësimit mbajnë një procesverbal që i bashkëlidhet deklaratës doganore dhe është pjesë e praktikës doganore.

Asgjesimi i këtyre produkteve do të kryhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar. Pjesë e praktikës duhet të jetë dhe dokumenti që shoqëron asgjësimin i cili është “dokumenti i transferimit” sipas përcaktimeve në këtë ligj. Dokumenti i transferimit duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) numrin e dokumentit të dorëzimit;
- b) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të transferuesit;
- c) emrin, adresën, numrin e telefonit dhe hollësi të tjera kontakti të personit, tek i cili transferohet mbetja (pritësi);
- ç) informacion për sasinë dhe tipin e mbetjeve jo të rrezikshme, që transferohen dhe tipin e konteinerëve/mjetit në të cilët ndodhen;
- d) vendin, kohën dhe datën e transferimit;
- dh) përshkrimin e mbetjeve jo të rrezikshme bashkë me listën e kodeve respektive;
- e) hollësi për trajtimet apo procese të tjera që mbetjet jo të rrezikshme kanë pësuar deri në këtë çast.

Deklarimi i mbetjeve teknologjike (produktet dytësore pa vlerë përdorimi) duhet të deklarohet maksimumi çdo tremujor, por dhe në një periudhë më të shkurtër nëse është e nevojshme.

Për çdo deklaratë IM 9 (9351) në dosjen e hapur për autorizimin përkatës përveç dokumentit të transferimit të jetë dhe proces verbal i mbajtur me landfill-in nëse ka, apo dokument tjetër që vërteton shkatërrimin/asgjësimin e mbetjeve. Gjithashtu, për çdo deklaratë IM 9 (9951) në dosje duhet të jetë një deklaram i operatorit ekonomik për sasinë dhe vlerën e mallrave që kanë marrë pjesë në procesin e prodhimit por nuk gjenden në produktet kompensuese (humbjet/firot).

4.3 Në rastin braktisje në favor të buxhetit të shtetit, plotësohet kutia 1 IM 7 dhe në kutinë 37 kombinohen kodet 9451 – **Braktisje** në favor të buxhetit të shtetit të mallrave të vendosura më parë në regjimin e përpunimit aktiv.

4.4 Në rastin e transferimit të mallrave ose produkteve të përpunuara nga një autorizim tek një tjetër autorizim i përpunimit aktiv plotësohet kutia 1 IM 5 dhe në kutinë 37, kombinohen kodet 5151 - Transferimi i mallrave apo produkteve të përpunuara të një regjimi të përpunimit aktiv tek një tjetër;

4.5 Në rastin e vendosjes nën regjimin e magazinimit doganor plotësohet kutia 1 IM 7 dhe në kutinë 37 kombinohen kodet 7151 - Vendosja në regjimin e magazinimit doganor të mallrave të vendosura më parë në regjimin e përpunimit aktiv.

4.6 Në rastin e hyrjes në një zonë të lirë plotësohet kutia 1 IM 7 dhe në kutinë 37 kombinohen kodet 7851 - Vendosja në një zonë të lire ose magazinë të lire të mallrave, më parë të vendosura në regjimin e përpunimit aktiv.

4.7 Në rastin e çlirimit për qarkullim të lirë plotësohet kutia 1 IM 4 dhe në kutinë 37 kombinohen kodet 4051- vendosje në qarkullim të lirë të mallrave më parë të vendosura në regjimin e përpunimit aktiv;

Kur produktet dytësore të përpunimit kanë vlerë përdorimi dhe nuk ri-eksportohen detyrimisht do t'u caktohet destinacioni i vendosjes në qarkullim të lirë sipas procedurave të paraqitura.

Deklarimi doganor do të shoqërohet me faturë në se këto mallra shiten, ku tregohet sasia dhe vlera e tyre. Nëse do të vazhdojnë të ngelen pronë e saj do të shoqërohet me një deklaratë për vlerësimin kontabël të tyre nga operatori ekonomik.

Shqyrtimi i vlerës doganore të këtyre produkteve bëhet sipas neneve 65 deri 71 të Kodit Doganor dhe neneve 148 deri 169 të VKM 651, datë 10.11.2017.

X. Transferimi dhe lëvizja e mallrave nga një autorizim te një autorizim tjetër.

1. Në rastet kur një pjesë e mallrave apo aksesorëve të futura në një autorizim trupëzohen në produktet e përpunuara të autorizimit të mëposhëm, mallrat apo produktet e përpunuara nga autorizimi i përpunimit aktiv të parë mund të kalojnë në autorizimin e përpunimit aktiv pasues me kusht që mbajtësi i autorizimit të jetë i njëjtë. Në këtë rast transferimi i mallrave apo produkteve të përpunuara kryhet me leje të degës doganore mbikëqyrëse. Për çdo transferim bëhet vetëm një deklaratë doganore ku në kutinë 37 të DAV vendoset kodi i procedurës 5151. Deklarata doganore do të lidhet me autorizimin në të cilin do të hyjnë mallrat, por në deklarate në kutinë 44 do të shenohet dhe numri i autorizimit nga i cili kanë dale mallrat (sipas shembullit bashkëlidhur udhëzimit).

2. Mallrat në gjendje të pandryshuar apo produktet e përpunuara, mund të transferohen nga një mbajtës në një mbajtës tjetër autorizimi të përpunimit aktiv. Përgjegjësia për mallrat ose produktet e transferuara i kalon mbajtësit të autorizimit të dytë në kohën në të cilën ai merr në dorëzim mallrat ose produktet në fjalë. Transferimi kryhet me autorizim të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Për çdo transferim bëhet një deklaratë doganore ku në kutinë 37 të DAV vendoset kodi i procedurës 5151. Deklarata doganore do të lidhet me autorizimin në të cilin do të hyjnë mallrat, por në deklarate në kutinë 44 do të shenohet dhe numri i autorizimit nga i cili kanë dalë mallrat (sipas shembullit bashkëlidhur udhëzimit).

XI. Bilanci material dhe faturimi.

1. Gjatë përpunimit në produktet kryesore dhe dytësore të përpunuara mund të trupëzohen edhe mallra shqiptare në varësi të proceseve që kryhen apo dhe interesave ekonomike të prodhuesit. Gjithashtu, këtyre produkteve ju rritet vlera për shkak të transformimit ku përfshihen puna, energjia, konsumi i teknologjisë fitimi i operatorit ekonomik etj.

2. Për të mundësuar një mbikëqyrje sa më të saktë dhe transparente të regjimit si dhe për të pasur një efekt ekonomik të matshëm operatori ekonomik në të gjitha rastet e rieksporit duhet të paraqitet fatura me këto elementë:

- Artikujt jo shqiptare që rieksporohen;
- Lloji;
- Sasia;
- Pesha neto (përfshin dhe ambalazhet kur janë mallra të importuara nën regjim);
- Peshën bruto;
- Vlera e produkteve të përpunuara që rieksporohet;

- Vlera e Shtuar (duke përfshirë edhe koston e mallrave shqiptare);
- Pesha e mallrave shqiptare të trupëzuara

Kjo faturë është e detyrueshme për qëllime doganore së bashku me regjistrat e importit dhe eksportit për mbikëqyrjen e regjimit.

XI. Plotësimi i deklaratës së ri-eksportit

Plotësimi i deklaratës së ri-eksportit do të kryhet si më poshtë:

1. Nëse pronar i mallrave jo shqiptare është një operator ekonomik i huaj, të gjitha operacionet e përpunimit bëhen për llogari të saj dhe të gjitha produkteve kryesore të përpunuara i jepet destinacion rieksporti drejt saj apo klientëve të saj:

- Në kutinë 22 të DAV vendoset - *vlera e faturuar* (vlera e punës + vlera e mallrave shqiptare);
- Kutia 44 e DAV, transporti i brendshëm vendoset – *vlera e mallrave të importuar* që është trupëzuar në produktin kryesor të përpunuar që po eksportohet (vetëm vlera e mallrave të importuar);
- Kutia 35 e DAV - pesha bruto;
- Kutia 38 e DAV, pesha neto - *Pesha neto* do të përfshijë: peshën e produktit kryesor të përpunuar (peshën e lëndëve të para të importuara + peshën e mallrave shqiptare të trupëzuara në këto produkte të përpunuara) + peshën e ambalazheve nëse këto ambalazhe janë importuar;

2. Nëse pronar i mallrave jo shqiptare është një operator ekonomik shqiptar i cili kryen operacionet e përpunimit për llogarinë e vet dhe i rieksporton produktet kryesore të përpunuar drejt klientë të saj të kontraktuar:

- Në kutinë 22 të DAV vendoset - *vlera e faturuar* (vlera e punës + vlera e mallrave shqiptare + vlera e mallrave të importuar);
- Kutia 44 e DAV, *transporti i brendshëm* vendoset – *vlera e mallrave të importuar* që është trupëzuar në produktin kryesor të përpunuar që po eksportohet (vetëm vlera e mallrave të importuar);
- Kutia 44 e DAV, zbritjet vendoset – *vlera e mallrave të importuar* që është trupëzuar në produktin kryesor të përpunuar që po eksportohet (vetëm vlera e mallrave të importuar);
- Kutia 35 e DAV, pesha bruto;
- Kutia 38 e DAV, pesha neto: *Pesha neto* do të përfshijë: peshën e produktit kryesor të përpunuar (peshën e lëndëve të para të importuara + peshën e mallrave shqiptare të trupëzuara në këto produkte të përpunuara) + peshën e ambalazheve nëse këto ambalazhe janë importuar;

Vlera e treguar në kutinë 44 të DAV - *transporti i brendshëm* do të përdoret për rakordimet në vlerë pasi tregon vlerën e mallrave të importuar që është rieksportuar.

XII. Rregulli i pagimit të detyrimeve për shkak të përfitimit të origjinës

1. Në zbatim të neneve 687 dhe 689 i VKM nr.651, datë 10.11.2017 dhe marreveshjeve në fuqi që ekzistojnë midis Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera të cilat parashikojnë dhënien e trajtimit tarifor preferencial për importim të mallrave më origjinë shqiptare në këto vende, kur mallrat e përpunuara nën regjimin e përpunimit aktiv janë përfunduar nga mallrat jo

origjinuese, këto të fundit të trupëzuara në produktet e përpunuara i nënshtrohen pagimit të taksës doganore që duhet paguar.

2. Në rastet kur mallrat e përpunuara përfitojnë origjinën preferenciale shqiptare, paisen me provën e origjinës preferenciale vetëm pasi paguajnë taksën doganore të pezulluar në hyrje për mallrat jo-origjinuese.

XIII. Mbikqyrja e Regjimit dhe kontrolli

1. Mbikëqyrje doganore e regjimit konsiderohet tërësia e rregullave të detyrueshme për zbatim dhe që mundësojnë mbajtjen në kontroll të zbatueshmërisë së kritereve të regjimit të përcaktuar në autorizim.

2. Mbikëqyrja dhe kontrolli i regjimit behet nga Zyra e Mbikqyrjes Doganore e përcaktuar në autorizim.

3. Kontrolli e regjimit mund të jetë dokumentar ose fizik.

4. Kontrollat dokumentare do të kryhen duke rakorduar për çdo rast hyrjet e mallrave në regjim me produktet e prodhuara të përftuara. Sipas deklaratave doganore, regjistrit të përpunimit aktiv dhe faturave të importit/eksportit si dhe duke hartuar një bilanc tremujor në formën e akt-rakordimit vetëm nën të njëjtin autorizim ndërmjet doganierit që ka si detyre funksionale ndjekjen e regjimeve dhe përfaqësuesit të operatori ekonomik.

5. Kontrollat fizike përfshijnë kontrollin e detyrueshëm të:

- koeficientit të shfrytëzimit;
- kontrollin fizik të mallrave të deklaruar në deklaratën e mbylljes së regjimit
- shkatërrimet e kryera nën kontrollin doganor ose të komunikuar nga kompania në rastet e forcave madhore; dhe
- kryerja e kontrolleve të stokut, mbështetur në analizën e profileve të riskut, në ambientet e operatorit ekonomik.
- Këto kontrolle fizike mund të kryhen në mënyrë të papritur ose duke e njoftuar paraprakisht përfaqësuesin e operatorit ekonomik. Në përfundimin e kontrolleve fizike duhet të përgatiten raporte përkatëse (proçes-verbal).

XIV. Detyrimet e operatorit ekonomik

1. Detyrimet e operatorit ekonomik ndaj Degës Doganore Mbikëqyrëse:

- Të depozitohet një *deklaratë mbi të dhënat për operatorin ekonomik*, sipas *aneksit 3*, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- Të depozitohet një kopje të autorizimit të aprovuar para se të ketë kryer veprime doganore;
- Të depozitohet një *deklaratën e mbajtësit të autorizimit për operatorët e tjerë ekonomik të miratuar në autorizim*, sipas *aneksit 4*, bashkëlidhur këtij udhëzimi, në lidhje me operatorët, ku konfirmohet se operatori pranon pa asnjë kusht kontrollin doganor në çdo kohe;
- Të mbajë *regjistrin e përpunimit aktiv*, për pasqyrimin e veprimeve të përpunimit aktiv për qëllime doganore, sipas *aneksit 5*, bashkëlidhur këtij udhëzimi;
- Të depozitohet zyrtarisht një kopje të çdo DAV-i me faturat përkatëse dhe regjistrin e importit apo eksportit sipas *aneksit 5*, të cilat mbahen në rrjedhë kronologjike për çdo artikull;

- Të depozitohet bashkëlidhur çdo praktike eksporti *formularin për taksën doganore preferenciale, sipas aneksit 6*, bashkëlidhur këtij udhëzimi, që pasqyron *detyrimin doganor të paguar për mallrat e importuara jo-origjinuese* nga të cilat janë përfituar produktet kryesore të prodhuara që rieksportohet në qoftë se ato në bazë të rregullave të origjinës pajisen me çertifikatën EUR 1. Ky formular është i bashkëlidhur me deklaratën doganore të eksportit;
- Të ketë të pasqyruar në mënyrë korrekte në librat e operatori ekonomik, sasinë e mallrave të cilat janë shpërndarë operatorëve për përpunim;
- Të mbajë një rregjister për mallrat që përpunohen nga operatorë të tjerë brënda dhe jashtë vëndit sipas *aneksit 7*.
- Të pranojë kontrollin doganor në çdo moment kur paraqitet;
- Të krijojë të gjitha mundësitë dokumentare dhe fizike për kontroll doganor.
- Të kryejë një bilanc tremujor në formën e akt-rakordimit në bashkëpunim me doganierin që ndjek regjimin.
- Të deklarojë produktet kompensuese dytësore (nëse ka) maksimumi çdo tremujor ose në periudhë më të shkurtër nëse është e nevojshme.

2. Pasi përfundon periudha e vlefshmërisë së autorizimit, përfshirë këtu edhe kohën e përpunimit të përcaktuar në pikën 13 të autorizimit, operatori ekonomik është i detyruar të dorëzojë pranë Degës Doganës Mbikëqyrëse *dokumentin e mbylljes së autorizimit*, sipas *aneksit 8*, bashkëlidhur këtij udhëzimi (neni 550 dhe aneksi 71 - 06 i Shtojcës A, të VKM nr.651, datë 10.11.2017). Megjithatë kjo kohë do të jetë më e shpejtë në rastet kur i jepet destinacion doganor produkteve të përpunuara. Koha e dorëzimit nuk mund të kalojë 30 ditë. Ky afat mund të shkojë deri në 60 ditë kur operatori ekonomik paraqet arsye për të justifikuar këtë zgjatje afati. Mosparaqitja në afat i dokumentit të mbylljes së autorizimit klasifikohet si parregullsi në zbatimin e këtij regjimi.

XV. Detyrimet e doganierit të mbikëqyrjes.

1. Për çdo regjim do të ketë një dosje, e cila duhet të përmbajë:

- Autorizimin e miratuar;
- Deklaratën e operatorit ekonomik origjinale;
- Deklaratën e operatorit ekonomik për koeficientin e shfrytëzimit;
- Raportin për verifikimin e koeficientit të shfrytëzimit;
- Raportin mbi asgjësimet e bëra nën kontrollin doganor dhe deklaratat doganore përkatëse;
- Shkeljet dhe kundravajtjet doganore të zbuluara së bashku me penalitetet përkatëse që janë vënë;
- Raportin për çdo kontroll të kryer pranë operatorit ekonomik;
- Aktrakordimet e mbajtura;
- Dokumentin e mbylljes së regjimit të miratuar.

2. Dokumenti i mbylljes së regjimit depozitohet nga operatori ekonomik dhe miratohet nga doganieri mbikëqyrës dhe kryetari i Degës Doganore.

3. Për miratimin e dokumentit të mbylljes së regjimit doganieri mbikëqyrës duhet të verifikojë regjistrin e importit dhe eksportit dhe nëse lind nevoja të gjithë dosjen e autorizimit përkatës. Me miratimin e dokumentit të mbylljes së regjimit dosja e plotë detyrimisht duhet të arkivohet.

XVI. Dispozita përfundimtare

1. Të gjithë operatorët ekonomik që disponojnë regjime përpunimi aktiv të vlefshme dhe në aktivitet duhet që të përshtasin aktivitetin e tyre sipas Kodit Doganor, Dispozitave Zbatuese të tij dhe këtij udhëzimi.
2. Udhëzimi i DPD nr.1, datë 6.09.2012 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”, i ndryshuar, shfuqizohet.
3. Ngarkohen strukturat doganore për zbatimin me korrektesë të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Belinda Ikonom



ANEKSI I

PROÇES VERBAL

I mbajtur sot më datë _____ në Zyrën e Degës Doganore _____		
Për operatorin ekonomik _____ Autorizimi Nr. _____ Datë _____		
Përfaqësuesi i operatorit ekonomik Z/Znj _____ Doganieri i mbikëqyrjes së regjimit Z/Znj _____		
Për akt-rakordimet vjetore u përdorën :		
Regjistri i importeve nga data _____ deri _____		
Regjistri i eksporteve nga data _____ deri _____		
Autorizuar :		
Sasia/pesha e autorizuar _____ në njësi matëse _____ në kg, Vlera e autorizuar _____ Euro/lekë		
Deklarata IM 5:		
Gjithsej numër _____		
Sasia/pesha e importuar _____ në njësi matëse _____ në kg		
Vlera e importuar(e importuar) _____ Euro/lekë		
Mallra shqiptare:	Sasia _____	Euro/lekë
	Vlera _____	Euro/lekë
Deklarata EX 3:		
Gjithsej numër _____		
Sasia e eksportuar/pesha _____ në njësi matëse _____ në kg		
Vlera e ri-eksportuar (e importuar) _____, (e shtuar) _____ Euro/lekë		
TDP e paguar _____ Euro/leke		
Deklarata IM 4:		
Gjithsej numër _____		
Sasia/pesha e kaluar në qarkullim të lirë _____ njësi matëse _____ kg		
Vlera e kaluar në qarkullim të lirë (e importuar) _____, (e shtuar) _____ Euro/lekë		
Detyrimi _____ Euro/leke		
Deklarata IM 9:		
Gjithsej numër _____		
Pesha e asgjësuar/humbur _____ kg		
Deklarata IM 5 (proc. 5151):		
Gjithsej numër _____		
Sasia/pesha e transferuar _____ njësi matëse _____ kg		
Vlera e transferuar _____ Euro/lekë		
Nga verifikimi dokumentar rezultoi se operatori ekonomik _____ Ka respektuar autorizimin në sasi, vlerë, kohë si dhe detyrimet e përcaktuara e tjera të përcaktuara në këtë udhëzim..... Koefiçentët e shfrytëzimit janë _____.		

PËRFAQËSUESI I FIRMËS

PËRFAQËSUESI I DOGANËS

ANEKSI 2

APLIKIM PËR PËRPUNIM AKTIV ME PROCEDURË TË THJESHTUAR

<p>1. Emri ose Emri i operatorit dhe Adresa: a) e aplikantit/deklaruesit/operatorit..... b) NIPT..... c) Adresa.....</p>
<p>2. Mallrat që do të përpunohen/riparohen: a) Përshkrimi tregtar dhe/ose teknik..... b) Kodi tarifor (4 ose 8 shifror).....</p>
<p>3. Mallrat e përpunuara/riparuara: a) Përshkrimi tregtar dhe/ose teknik..... b) Kodi tarifor (4 ose 8 shifror).....</p>
<p>4. Metoda e rekomanduar për identifikimin e mallrave të importit në produktet e gatshme:</p>
<p>5. Llojet e operacioneve/vëndi ku do të kryhen:</p>
<p>6. Periudha e parashikuar për ri-eksportim/ri-importim:</p>
<p>7. Dega doganore:</p>
<p>8. Deklarim nga shoqëria (aktiviteti do të jetë në përputhje me legjislacionin doganor mbi regjimet doganore):.....</p>
<p>9. Përfaqësuesi: Emri/mbiemri/nënshkrimi/vula Data.....</p>
<p>10. Nr. _____ Prot., i Degës Doganore, datë _____ / _____ / _____. Vula e Degës Doganore</p>

ANEKSI 3

DEKLARATË MBI TË DHËNAT PËR OPERATORIN EKONOMIK

Operatori ekonomik _____ me numër NIPT _____

Deklaroj se :

Në marrëdhëniet me doganën për regjimin e përpunimit aktiv nr. _____ datë _____
do të përfaqësohem nga _____ dhe agjencia doganore _____.
Selia e operatorit ekonomik ndodhet në adresën: _____
Telefoni i kontaktit: _____ e-mail: _____
Adresa e repartit ku kryen operacionet e përpunimit: _____
Adresa e magazinës ku do të depozitohen mallrat dhe produktet e përpunuara:

Me anë të kësaj deklarate marr përsipër të vërtetoj se informacioni i mësipërm është i saktë dhe për çdo ndryshim të tij marr përsipër të njoftoj me të njëjtën deklaratë, të paktën 10 ditë para.

Për çdo njoftim, dega doganore mund të drejtohet në adresat e mësipërme.

Deklaroj se në adresat e mësipërme pranoj pa asnjë kusht kontrollin doganor të autorizuar nga Dega Doganore mbikëqyrëse apo Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Deklaroj se mallrat e vendosura nën regjim do të ndodhen vetëm në ambjentet e sipërpërmendura.

Administratori i operatorit ekonomik

(nënshkruar dhe vulosur)

ANEKSI 4

DEKLARATË E MBAJTËSIT TË AUTORIZIMIT PËR OPERATORËT E TJERË EKONOMIK TË MIRATUAR NË AUTORIZIM

Mbajtësi i autorizimit _____ me numër NIPT _____

Deklaroj se:

Në autorizimin e regjimit të përpunimit aktiv nr _____ datë _____ kam këto operatorë të miratuar:

- Operatori ekonomik _____
Adresa _____
- Operatori ekonomik _____
Adresa _____
- Operatori ekonomik _____
Adresa _____
- Operatori ekonomik _____
Adresa _____
- Operatori ekonomik _____
Adresa _____
- Operatori ekonomik _____
Adresa _____

Me anë të kësaj deklarate marr përsipër të vërtetoj se informacioni i mësipërm është i saktë dhe se jam i detyruar që për çdo ndryshim të tij të njoftoj me të njëjtën deklaratë të paktën 10 ditë para.

Unë, mbajtësi i autorizimit deklaroj se nga operatorët ekonomik (në adresat e mësipërme) do të pranohet pa asnjë kusht kontrolli nga autoritetet doganore.

Administratori i operatorit ekonomik

(nënshkruar dhe vulosur)

ANEKSI 5

REGJISTËR I PËRPUNIMIT AKTIV

E vlefshme për autorizimin Nr Datë

Mbajtësi i autorizimit, emri dhe adresa.....

IMPORT

Numri i regjistrimit të deklaratës	Data e deklaratës	Kodi i mallit 4-shifror	Përshkrimi i mallit	Pesha në Kg	Sasia (në njësi matëse)	Vlera	Detyrimet doganore

MALLRA SHQIPTARE

Data	Kodi i mallit 4-shifror	Përshkrimi i mallit	Pesha (në Kg)	Sasia (në njësi matëse)	Vlera	Shënime

RIEKSPORT

Numri i regjistrimit të deklaratës	Data e deklaratës	Kodi i mallit	Përshkrimi i mallit	Pesha në në Kg	Sasia në njësi matëse	Vlera në Lekë	TDP	Vlera e mallrave të importuara

DESTINACIONE TE TJERA

Numri i regjistrimit të deklaratës	Data e deklaratës	Kodi i mallit	Përshkrimi i mallit	Pesha në në Kg	Sasia në njësi matëse	Vlera	Detyrimet doganore

ANEKSI 7

REGJISTËR PËR MALLRAT E PËRPUNUARA NGA OPERATORËT

E vlefshme për autorizimin Nr Datë

Mbajtësi i autorizimit, emri dhe adresa.....

BRËNDA VËNDIT

Numri rendor	Data e nisjes/mbrirjes	Kodi i mallit 4-shifror	Përshkrimi i mallit	Pesha në Kg	Sasia (në njësi matëse)	Vlera	Vlera shtuar

JASHTË VËNDIT NËN RPP NR....., DATË.....

Numri i regjistrimit të deklaratës 2151,6221	Data e deklaratës	Kodi i mallit 4-shifror	Përshkrimi i mallit	Pesha në Kg	Sasia (në njësi matëse)	Vlera	Vlera shtuar	Detyrimi

ANEKS 8

DOKUMENTI I MBYLLJES SË AUTORIZIMIT

Operatori ekonomik _____
me numër NIPT _____

Regjim e përpunimit aktiv nr _____ datë _____

Ka importuar IM 5

nr	Artikulli (kodi NK 4-shifror)	Sasia	Vlera	Pesha	Detyrimi

Ka futur në përpunim mallra shqitare/ mallra ekuivalente

nr	Artikulli (kodi NK 4-shifror)	Sasia	Vlera	Pesha

Ka rieksporuar produktet kryesore të përpunuara EX3

nr	Artikulli (kodi NK 4-shifror)	Sasia	Vlera	Vlera e shtuar	Pesha	Detyrimet

Ka hedhur në qarkullim të lire IM 4

nr	Artikulli (kodi NK 4-shifror)	Sasia	Vlera	Pesha	Detyrimet

Ka transferuar _____

nr	Artikulli (kodi NK 4-shifror)	Sasia	Vlera	Pesha	Detyrimet

Ka rieksporuar produkte dytësore të përpunimit EX 3

nr	Artikulli (kodi NK 4-shifror)	Sasia	Vlera	Pesha

Ka asgjësuar produkte dytësore të përpunimit IM 9

nr	Artikulli (kodi NK 4-shifror)	Sasia	Vlera	Pesha

Humbje dhe firo IM 9

nr	Artikulli (kodi NK 4-shifror)	Sasia	Vlera	Pesha

Koefiçienti i shfrytëzimit	
Mënyra e përdorur për llogaritjen e detyrimit doganor	
Periudha për mbylljen	
Administratori i operatori ekonomik	Doganieri mbikëqyrës
	Nr _____ Prot Dt _____
	Kryetari i Degës Doganore

ANEKSI 9
DEKLARIM PËR KUSHTIN EKONOMIK

Rastet në të cilat kushtet ekonomike konsiderohen të plotësuar
(Pika 5 e nenit të Kodit dhe 537 të VKM nr. 651, datë 10.11.2017)

1	Përpunimi i mallrave, përveç mallrave të listuara në aneksin 71-02	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo
2	Riparimi i mallrave	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo
3	Përpunimi i mallrave në emër të një personi tjetër jashtë territorit shqiptar(fason)	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo
4	Përpunimin e mallrave të listuara në aneksin 71-02 ne nje nga situatat e mëposhtme: - mungesa e mallrave të prodhuara në Republikën e Shqipërisë (sipas rasteve te listuara në pikën 2 të nenit 537) - diferencat në çmim mes mallrave të prodhuara në Republikën e Shqipërisë dhe atyre të destinuara për importim nën RPA - detyrimet kontraktuale kur mallrat e krahasueshme nuk janë në përputhje me kërkesat kontraktuale të blerësit të një vendi tjetër për produktet e përpunuara. - vlera totale e mallrave për t'u vendosur nën regjimin e përpunimit aktiv për aplikues, vit kalendarik dhe për çdo kod tetëshifror të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) euro;	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo <input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo <input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo <input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo
5	Përpunimi i grurit të fortë (durum) në makarona	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo
6	Përpunimin e mallrave për të siguruar përputhjen e tyre me kërkesat teknike për çlirim në qarkullim të lirë;	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo
7	Përpunimin e mallrave të natyrës jotregtare;	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo
8	Përpunimin e mallrave bazuar në një autorizim të mëparshëm, lëshimi i të cilit ishte objekt i shqyrtimit të kushteve ekonomike;	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo
9	Përpunimin e çdo lloji të komponenteve elektronikë, pjesëve, bashkimeve apo ndonjë materiali tjetër në produkte të teknologjisë së informacionit	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo
10	Reduktimin në mbeturina dhe skrap, shkatërrimin, rikuperimin e pjesëve ose komponentëve;	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo
11	Denatyrimin	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo
12	Format e zakonshme të trajtimit të përmendura në nenin 199 të Kodit	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo
13	Vlerën totale të mallrave për t'u vendosur në regjimin e përpunimit aktiv për aplikues, vit kalendarik dhe për çdo kod tetëshifror të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave nuk e kalon vlerën ekuivalente të përcaktuar në pikën 1/"n" të nenit 537.	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo
14	Rastet e tjera të parashikuara në nenin 537 të pa listuara në këtë aneks	<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo

Aneksi 71-02
Mallra dhe produkte sensitive

Ky aneks përfshin mallrat e mëposhtme:

1) Produktet bujqësore që kategorizohen si vijon:

- mishi i kaut dhe viçit;
- mishi i derrat;
- mishi i deles dhe mishi i dhisë;
- vezë;
- mishi i shpendëve;
- produkte të apicultures;
- drithërat;
- orizi;
- sheqeri;
- vaji i ullirt;
- qumështi dhe produkte të qumështit;
- vera

2) Alkool etilik dhe produkte alkoolike:

2207 10

2207 20

2208 40 39 – 2208 40 99

2208 90 91 – 2208 90 99

3) ex 2401 duhan i papërpunuar

4) Produkte ndryshe nga ato të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 që janë objekt i kompensimit të eksporteve bujqësore.

5) Produkte të peshkut objekt i një pezullimi autonom të pjesshëm.

6) Të gjitha produktet e peshkimit objekt i kuotës autonome.

Shembull në lidhje me mbikëqyrjen e regjimit të përpunimit aktiv

Importi

Metrazh xhins	100 ml	400 €	70 Kg
Penjë	2 Kg	20 €	2 Kg
Kopsa	500 copë	10 €	2 Kg
Preparate kimike për larje	5 Kg	50 €	5 Kg
Total		480 €	79 Kg

Mallra shqiptare të përdorura

Qese ambalazhimi	100 copë	20 €	4 Kg
Kuti kartoni	20 copë	40 €	10 Kg

Rieksporti

Pantallona xhins të ambalazuara	90 palë	432 €	kjo vlerë do të pasqyrohet në DAV tek transporti i brendshëm	66.6 Kg
Vlera e shtuar		1000 €	kjo vlerë përfshin vlerën e mallrave shqiptarë + vlera e punës (kutia 22 e DAV)	
Vlera e DAV në rieksport		1432 €	kjo vlerë pasqyrohen në kutinë 46 të DAV vlera statistikore	66.6 Kg
Humbje nga larja			IM 9	7 Kg
Mbetje nga prerja dhe qepja (produkt kompesues dytësor)			IM9 ose IM4 ose EX3	12 Kg

Hedhje për qarkullim të lirë

Pantallona xhins të ambalazuara të hedhura për qarkullim të lirë	10 palë	48 €	IM 4	7.4 Kg
--	---------	------	------	--------

Në lidhje me të dhënat e mësipërme kontrolli dhe mbikëqyrja do të behet sipas kësaj metodike:

Përcaktimi i koeficientit të shfrytëzimit

Penjtë dhe kopsat nuk kanë asnjë humbje.

Metrazhi gjatë përpunimit dhe larjes ka humbur 2 Kg për caktimin e koeficientit vepohet:

$$68/70 = 0.97 \times 100 = 97\%$$

Preparatet kimike humbasin plotësisht gjatë procesit të larjes pra koeficienti i shfrytëzimit është 0

Kontrolli i regjimit në vlerë

Vlera totale e importuar $400 + 20 + 10 + 50 = 480 \text{ €}$

Vlera e rieksportuar + vlera e hedhjes në qarkullim të lirë $432 + 48 = 480 \text{ €}$

Diferenca mes vlerës së importuar dhe asaj të rieksportuar ose hedhur në qarkullim të lirë është $480 \text{ €} - 480 \text{ €} = 0$ çka do të thotë se gjithë vlera është trupëzuar në produktin kompesues parësor dhe është rieksportuar. Produktet kompesuese dytësore nuk kanë vlerë të mbartur në destinacionin doganor që do të marrin.

Kontrolli i regjimit në sasi

Pesha e importuar 79 Kg;

Humbjet, firot 7 Kg;

Mallra shqiptare 14 Kg;

Produkte kompesuese parësore 74 Kg (66.6 + 7.4);

Produkte kompesuese dytësore 12 Kg;

Pesha që futet në proces përpunimi	Pesha sipas destinacioneve doganore
79 (Pesha e importuar)	74 (Produkte kompesuese parësore)
14 (Mallra shqiptare)	12 (Produkte kompesuese dytësore)
	7 (Humbje, firo)
93 Shuma	93 Shuma

Siç shihet nga kontrolli në sasi regjimi ka funksionuar në mënyrë korrekte.

Procedurat doganore që përdoren

Metrazh xhins	5100	100 ml	400 €	70 Kg
Penjë	5100	2 Kg	20 €	2 Kg
Kopsa	5100	500 copë	10 €	2 Kg
Preparate kimike për larje	5100	5 Kg	50 €	5 Kg

Pantallona xhins të ambalazuara të ri-eksportuara	3151	90 palë	432 €	66.6 Kg
Pantallona xhins të ambalazuara të hedhura në qarkullim të lirë	4051	10 palë	48 €	7.4 Kg
Humbje nga larja	9951			7 Kg
Mbetje nga prerja dhe qepja (produkt kompesues dytësor)	3151 4051			12 Kg

Në rastin kur produktet kompesuese dytësore hidhen në qarkullim të lirë më procedurën 4051 dhe gjithë vlera është trupëzuar në produktet kompesuese parësore atëherë për këtë vlerë shoqëria është e detyruar të vetëdeklarojë në bazë të vlerës së tregut që ky produkt do të ketë. Kjo vlerë shërben më vonë edhe për kontabilitetin e shoqërisë në lidhje më marrëdhëniet tatimore. Në të gjitha rastet dhënia e destinacionit doganor bëhet pasi mbaron procesi i prodhimit dhe jo paraprakisht.



2 Exporter WIN SOLE SHPK DURRES PER GIRZA SPA ITALI		No		DECLARATION IM 5		AL140000 Durresi Customs Reference	
3 Forms 1 1		4 Load List Manifest		R 12045		16/02/2019	
5 Items 1		6 Nbr packages 208		7 Reference number 2019 AN114			
8 Consignee FITAL SHPK BASHKIA KAMEZ,BATHORE NR. 6 TIRANE TIRANE				9 Financial No			
10 City, dest IT		11 Trading or: prev. IT city.		12 Value details 0		13 C.A.P.	
14 Declarant Aiden 2018 Lagjia 1,brenda autoritetit portual Durres				15 Country of export Italia		15 C.E. Code a IT b	
16 Identity and nationality of means of transport at arrival / at AA962KB AL no				19 Ctr. no			
21 Identity and nationality of active means of transport crossing the border PER PROCEDURE .16.02.2019 IT				20 Delivery terms EXW ITALI		23 Exch. rate 124.640	
25 Mode transport 10 at border		26 Inland mode 33 Transport		27 Place of loading/unloading		24 Nature of 1 1 transac.	
29 Office of entry/exit AL140 Durresi				30 Location of goods			
31 Packages and description of goods		32 Item 1 No.		33 Commodity code 64062090 000			
34 City, orig. Code a IT b		35 Gross mass (kg) 2,740.3200		36 Prefer.			
37 PROCEDURE 5151 000		38 Net mass (kg) 2,608.0000		39 Quota			
40 Summary declaration / Previous document S/L							
41 Supplementary units		42 Item Price 9,473		43 V.M. 1 pod			
44 Add. info Documents Produced Certificates and authorization		45 Adjustment 1.000		46 Statistical value 364,193			
47 Calculation of taxes							
Type		Tax base		Rate		Amount	
DOG		364,193		0.00		0 0	
TVS		1,180,714		0.20		236,143 0	
48 Deferred payment				49 Identification of warehouse 180			
B ACCOUNTING DETAILS							
Mode of payment KESH				Assessment number P 12090 / Date 16/02/2019			

Autorizimi nga transferohen mallrat

Autorizimi ku transferohen mallrat



2 Exporter ALBAN.DEL-SHPK Rr.ABDI TOPTANI,TORRE DRIN, NR.KATI 2, TIRANE TIRANE		No. K01825012J		DECLARATION EX 2 01 AL140000 Durrësi Customs Reference		10AL14000014244R5	
3 Forms 1 3		4 Load List R 14244 Manifest		23 Exch. rate 23:02/2019		7 Reference number 2019 D144	
5 items 5		6 Nbr packages 5		9 Financial No		13 C.A.P.	
8 Consignee -TOD'S SPA - TRIO SRL - MIGAMMA DI MINICUCCI; - NEW & BEST H.F. SRL - FRAMMAR SRL ITALIA		10 Ctry. of dest AL		11 Tracing of prov. IT		12 C.A.P.	
14 Declarant ALBADIAN 2012 Tirane Tirane		15 Country of export Albania		16 Country of origin Albania		17 C.D. Code a AL b a IT b	
18 Identity and nationality of means of transport at arrival / at XA 850 HV (KOKE DR. 7917 E)		19 Ctr IT no		20 Delivery terms DDP ITALIA		17 Country of destination Italia	
21 Identity and nationality of active means of transport crossing the border		22 Currency & total amount invoiced EUR 3.580,64		23 Exch. rate 124,640		24 Nature of 4 1 transac.	
25 Mode transport 10 at border		26 Inland mode 31 Transport		27 Piece of loading/unloading		28 Financial and banking data Bank Terms of payment	
29 Office of entry/exit AL140 Durrësi		30 Location of goods		31 Commodity code 1 No. 64061010 000		32 Item	
31 Packages and description of goods Marks and numbers - Containers No(s) - Number and kind Marks & no Prites: Tod's SPA or List.Valorizat.056 Number and 1 21 Kind Kartona Containers No(s) -- Prej lekure 36pl Piese tomate per t'u punuar		34 Ctry. orig. Code a AL b 1 0000		35 Gross mass (kg) 1 0000		36 Prefer. MSABE	
44 Add. info Documents Produced Certificates and authorization Autorizimi i RPA RPA 20180612/8965/1		Autorizimi i RPP 20181224/28868/1		37 PROCEDURE 2151 000 0.5800		38 Quota	
47 Calculation of taxes		48 Deferred payment		49 Identification of warehouse 360		40 Summary declaration / Previous document 3/L	
Type Tax base Rate Amount MP		41 Supplementary units		42 Y.M.		43 V.M.	
B ACCOUNTING DETAILS Mode of payment KESH Assessment number P 14421 Date 23/02/2019 Receipt number Date Guarantee 0 All Date		44 Statistical value 51,534		45 Adjustment		46 A.I. Code	